

## Broshurë lajmesh për kosovarët në Danimarkë

Botuar nga Dansk Flygtningehjælp

Nr. 2, 2006

Kjo broshurë botohet nga Dansk Flygtningehjælp, që është një organizatë që punon pavarësisht nga interesat politike dhe shtetërore. Dansk Røde Kors (Kryqi i Kuq Danez dhe Care4You Association (Shoqata Kujdesi për Ju), kanë dhënë kontribut në lidhje me përmbajtjen

Lexoni në këtë numër për:

- **S'ka amnisti për kosovarë dhe irakenë të refuzuar (në çështjet e azilit)**

Dansk Flygtningehjælp ka propozuar që disa grupe të refugjatëve që kanë marrë refuzim në lidhje me kërkesat e tyre për azil, dhe që nuk kanë mundësi për tu dërguar në atdheun e tyre, t'u jepet një leje qendrimi e përkohshme qendrimi. Pas një takimi me Ministren e Integritimit, duhet të konstatojmë se kërkesa nuk ka mbështetje politike.

- **Mundësitë në Danimarkë**

Kosovarët që kanë marrë refuzim përfundimtar për leje qendrimi në Danimarkë, rekomandohen të paraqiten tek Dansk Flygtningehjælp, Care4You Association Dansk Røde Kors, ku tek të gjithë ofrohen mundësi të ndryshme arsimimi dhe këshillimi. Paraqitja aty, nuk ju detyron në asnjë lloj forme për dicka. Lexoni më shumë në lidhje me mundësitë.

- **Mundësitë në Kosovë**

Cfarë do të bëj unë, dhe ka ndonjë lloj sigurie për mua dhe familjen time në Kosovë? Këto pyetje dhe shumë të tjera u diskutuan gjatë takimeve midis kosovarëve në Danimarkë dhe 3 kosovarëve nga zyra e Dansk Flygtningehjælp në Kosovë.

---

**Broshurë lajmesh për kosovarët në Danimarkë** botohet nga Dansk Flygtningehjælp. Redaktore përgjegjëse është Anne-Dorthe Helmich, Dansk Flygtningehjælp. Redaktimi: Ole Larsen, Dansk Flygtningehjælp, Borgergade 10,3. Postboks 53, 1002 København K. Tlf. 3373 5000. Fax 3391 4507. [www.flygtning.dk](http://www.flygtning.dk). Redaktimi përfundoi më 5. maj 2006. Broshura mund të kopjohet. Kopje të tjera mund të merren duke u paraqitur tek Dansk Flygtningehjælp, Asyl og Repatriering. Tlf. 3373 5237. E-mail: [ole.larsen@drc.dk](mailto:ole.larsen@drc.dk)

### **S'ka amnisti për kosovarë dhe irakenë të refuzuar (në çështjet e azilit)**

Dansk Flygtningehjælp ka propozuar që disa grupe të refugjatëve që kanë marrë refuzim në lidhje me kërkesat e tyre për azil, dhe që nuk kanë mundësi për tu dërguar në atdheun e tyre, t'u jepet një leje qendrimi e përkohshme qendrimi. Pas një takimi me Ministren e Integritimit, duhet të konstatojmë se kërkesa nuk ka mbështetje politike.

Dansk Flygtningehjælp prezantoi para pak kohësh një sërë propozimesh, ku të gjitha së bashku kishin si qëllim përmirësimin e kushteve për azilkërkuesit në qendrat e azilit. Një nga propozimet ishte dhënia e lejeve të përkohshme të qendrimit për azilkërkuesit e refuzuar nga Iraku dhe Kosova, të cilët kanë ndejtur shumë vite në Danimarkë, dhe që nuk mund të dërgohen në shtëpi me detyrim.

Pas një shqyrtimim me Ministren përkatëse, Ministren e Integritimit, Rikke Hvilshøj, Dansk Flygtningehjælp konkludoi se nuk ka mbështetje politike për propozimin. Azilkërkuesit nga Iraku dhe Kosova nuk duhet të presin ndryshime në lidhje statusin e tyre në Danimarkë. Si organizatë humanitare që është, Dansk Flygtningehjælp nuk ka mundësi për të ndryshuar këtë. Kjo është në varësi të autoriteteve daneze të emigracionit.

Duke u mbështetur në këtë fakt, Dansk Flygtningehjælp do të vazhdojë të punojë më tej duke mbështetur sa më shumë kosovarë që të jetë e mundur, që këta të arrijnë të kenë një rikthim me vlerë për në shtëpi. Ne do të punojmë dhe rekomandojmë që azilkërkuesit e refuzuar të përgatiten sa më mirë këtu në Danimarkë, dhe ne do të bëjmë ç'është e mundur që në momentin e mbërritjes në Kosovë, të ketë mundësi mbështetëse

Lexoni të gjitha propozimet në [www.flygtning.dk](http://www.flygtning.dk) (vetëm në danisht)

---

### **Mundësitë në Danimarkë**

Kosovarët që kanë marrë refuzim përfundimtar për leje qendrimi në Danimarkë, rekomandohen të paraqiten tek Dansk Flygtningehjælp, Care4You Association Dansk Røde Kors, ku tek të gjithë ofrohen mundësi të ndryshme arsimimi dhe këshillimi. Paraqitja aty, nuk ju detyron në asnjë lloj forme për dicka. Lexoni më shumë në lidhje me mundësitë.

### **Këshillim dhe biseda me Dansk Flygtningehjælp**

Dansk Flygtningehjælp ofron këshillim individual për të gjithë kosovarët që kanë refuzim të kërkesës për leje qëndrimi në Danimarkë. Në këshillim do të keni mundësinë për të folur me një jurist në lidhje me çështjen tuaj të azilit, si dhe me një këshilltar me kështjehënë në çështjet e riatdhesimit, në lidhje me mundësitë dhe sfidat e një rikthimi në Kosovë.

Dansk Flygtningehjælp vjen shpesh në qendrat e azilit. Ju jenim natyrisht të mirëpritur të na kontaktoni ne, qoftë edhe nëpërmjet një punonjësi të qendrës në tel: 3373 5230. Vini re se ditët e marta në orarin 13 – 14, ka këshillim telefonik në shqip/serbokroatisht në të njëjtin numër.

### **Kthim në punë – kurse tek Dansk Røde Kors**

Në qendrën Jelling në Jyllandë dhe në Kulturhuset në Kopenhagë, ju mund të merrni pjesë në kurse të ndryshme, ku mësimdhënia i përshtatet nevojave të pjesëmarrësve.

Ju mund të merrni dëshminë e ndihmës së parë, mund të merrni mësim në lidhje me shëndetin, mund të shkoni në kurs për kompjuter ose një kurs për fillestar në biznes, në rast se ju mendoni të nisni një biznes. Egziston edhe mundësia e kombinimit të kursit me praktikë në një biznes.

Të gjithë pjesëmarrësit përpunojnë një CV, e cila tregon resurset dhe kompetencat për punë të personit në fjalë. Pas përfundimit të periudhës, ne përpunojmë një dëshmi (port folio) për diploma dhe CV. Ne ofrojmë gjithashtu edhe udhëzime, biseda dhe mësimdhënie për të gjithë familjen së bashku, gjë e cila përgatit familjen për të ardhmen, kur të rifillojë një jetë të re pas kohës si azilkërkues

Për lajmërim ose për më tepër informacion, kontaktoni me Lars Brügger tek Dansk Røde Kors Kulturhus në telefon 3296 0088 ose [lab@redcross.dk](mailto:lab@redcross.dk)

### **Kurs udhëzues nga Care4You për kosovarë.**

Në përfundim të kursit tek Røde Kors, ju keni mundësi të merrni pjesë në një kurs të vecantë orientues, që bën të mundur ndërthurjen dhe qartëson cilësitë tuaja personale, dhe profesionale në lidhje me të ardhmen në Kosovë, ose në një vend tjetër, këtu punohet sidomos në lidhje me përpunimin e një plani për punësim, qoftë si I punësuar, ose si punëdhënë. Ndër të tjera jepen udhëzime edhe për mundësitë për aktivitete për azilkërkues të refuzuar nga 1 shtatori 2006.

Periudha e kursit orientues do të jetë një kombinim i orientimit në grup dhe aktiviteteve individuale, tërësisht në varësi të nevojave dhe resurseve të personave

pjesëmarrës. Në varësi të mundësive egzistuese, do të ketë përfshirje të kompjuterëve në aktivitete. Këtu mendohet ndër të tjera psh. kërkimi i informacioneve në internet, si dhe përmbushja e SPOR (program udhëzues).

Kursi organizohet nga Care4You për 3 ditë në qendrën Jelling (në perëndim të Storebælt) dhe nga Røde Kors Kulturhus (në lindje të Storebælt). Më pas do të ketë mundësi për biseda pasuese dhe udhëzime tek Care4You.

Ju mund të kontaktoni Søren Egdal nga Care4You Association në postën elektronike: [se@care4you.dk](mailto:se@care4you.dk) ose celular: 2044 2468.

Keni parasysh se të gjitha paraqitjet tek oraganizatrat humanitare daneze janë të padetyrueshme dhe anonime, nëse ju e dëshironi këtë gjë.

---

### **Mundësitë tuaja në Kosovë?**

Cfarë do të bëj unë, dhe ka ndonjë lloj sigurie për mua dhe familjen time në Kosovë? Këto pyetje dhe shumë të tjera u diskutuan gjatë takimeve midis kosovarëve në Danimarkë dhe 3 kosovarëve nga zyra e Dansk Flygtningehjælp në Kosovë.

Azilkërkuesit e refuzuar nga Kosova gjenden në një situatë të vështirë në Danimarkë. Mundësitë për të qëndruar në Danimarkë, duken të pakta, ndërsa gjithnjë e më tepër, ose thënë më mirë, nuk ka probleme për tu rikthyer në Kosovë. Ata 3 persona që ishin për vizitë nga Kosova, punojnë në mënyra të ndryshme për të mbështetur personat që rikthehen tek ajo shtëpi, nga e cila u detyruan të ikin. Një bashkëpunor punon me përmirësimin e kushteve për ciganët në Mitrovicë, një tjetër punon me këshillimin për biznes dhe këshilla të vlefshme për blerjen e makinerive të biznesit, ndërsa i treti punon me planifikimin dhe mbikqyrjen e rikthimit në Kosovë.

### **Roma Mahalla në Mitrovicë**

Në Danimarkë gjenden më shumë se 30 familje cigane që kanë marrë negativ. Shumica vjen nga Gjilani. Milena B. Djerić, një nga personat nga zyra e Dansk Flygtningehjælp në Kosovë, punon me një projekt në Mitrovicë që quhet Roma Mahalla, që në shumë drejtime ka synim përmirësimin e kushteve për ciganët. Milena B. Djerić thotë:

“Në Mitrovicë ka qenë me të vërtetë e nevojshme të krijohen kushte normale jetese, vecanërisht për ciganët. Sot ka shkolla me mësues ciganë, ka ambulanca me mjekë, është duke u bërë një stacion policie, dhe aty trajnohen policë ciganë. Në Danimarkë unë fola me shumë ciganë, nëse ata mund të ndihmohen për të regjistruar fëmijët e tyre në Kosovë. Nëse fëmijët nuk janë të regjistruar, kjo do t’ju

shkaktojë probleme më vonë, ndër të tjera për të arritur të drejtën për ndihma sociale”.

Për momentin nuk ka aq shumë aktivitete për ciganët në Gjilan. Por, sipas Milena B. Djerić, situata në Gjilan nuk është aq keq sa në Mitrovicë. Tani në Gjilan banojnë familje cigane, dhe ata mund të lëvizin lirisht ndër shqiptarë.

### **Punë në Kosovë**

Në Kosovë ka një papunësi të lartë, që bën të vështirë arritjen e një rroge të kënaqshme. Aty ka edhe projekte të ndryshme, që kanë synim lehtësimin e vështirësive për nisjen e një biznesi të vogël, bujqësi etj. Fatmir Hapciu, gjithashtu nga Dansk Flygtningehjælp në Kosovë thotë:

”Në Kosovë ka institucione të ndryshme mikrokrediti, që ofrojnë kredi të lira për hapjen e bizneseve të vogla. Ndër të tjera, zyra jonë mund të ofrojë këshillim dhe mbështetje për blerjen e paisjeve të punës për persona që rikthehen nga Danimarka”.

Fatmir Hapciu nënvizon se, megjithë mundësitë për mbështetje, fillimi i një biznesi të vogël në Kosovë, është një sfidë shumë e madhe për njeriun e zakonshëm.

Papunësia është e lartë, dhe nevojiten ide të mira dhe punë intensive për të arritur tek një rrogë e kënaqshme në një ekonomi të vështirë.

### **Siguria në Kosovë**

Kombet e Bashkuara dhe organizatat lokale raportojnë se ka përparim të sigurisë në Kosovë. Në 2006 nuk është raportuar për ngjarje të dhunshme mes dy ose më shumë grupeve të ndryshme etnike. Në përgjithësi, gjithnjë e më shumë minoritete etnike mund të lëvizin lirshëm dhe të sigurtë. Por në disa zonamund të ketë probleme, psh. për serbët, nëse ata duan të lëvizin jashtë zonës së tyre lokale.

Policia në Kosovë është me përbërje multietnike, dmth. ka shqiptarë, serbë, ciganë, ashkalinj, egjiptianë dhe turq. KFOR gjendet gjithandej në Kosovë, por vetëm me patrulla të rastësishme.

### **Mundësitë tuaja për mbështetje në Kosovë:**

Pas një vlerësimi konkret, sipas nevojave mund të jepet mbështetje për në Kosovë për :

- Marrjen dhe transportin e paketave me mobilje, ushqim, artikuj higjieno-sanitarë paisje etj. Deri në një adresë të informuar më parë.
- Mbështetje për riparime të vogla të shtëpive, qera për një periudhë të shkurtër etj.
- Mbështetje për aktivitete që krijojnë të ardhura, psh. paisje për biznes.

Në mënyrë më të përgjithshme:

- Nga 2005 është krijuar mundësia për të marrë kredi me interesa të ulëta bankare për fillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Kreditë merren tek një i ashtuquajtur, institut për financime të vogla, me interesa kredie që janë më të ulëta se në banka.
- Nga 4 marsi 2006 Kosovo Property Agency (KPA) ka zëvendësuar Housing and Property Directorate, që ishte më parë. KPA ka si qëllim të shqyrtojë kërkesa në lidhje me pasuri të humbura, përfshirë ferma bujqësore dhe ndërtesa biznesi. Humbja e pasurisë duhet të ketë ndodhur gjatë konfliktit të armatosur në periudhën 27 shkurt 1998 deri në 20 qershor 1999. Lexoni më tepër në [www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org)

Për më tepër informacin, kontaktoni Dansk Flygtningehjælp në tel: 3373 5230. Vini re se ditët e marta, në orarin 13 – 14 ka këshillim telefonik në shqip/serbokroatisht në të njëjtin numër.